




Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action

RAPORT I MONITORIMIT TË FUSHATËS ZGJEDHORE

ZGJEDHJET PARLAMENTARE
TË 9 SHKURTIT 2025

MARS 2025



RAPORT I MONITORIMIT TË FUSHATËS ZGJEDHORE

**ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË
9 SHKURTIT 2025**

E drejta e autorit © 2025. Demokracia në Veprim (DnV)

Demokracia në Veprim (DnV) rezervon të gjitha të drejtat dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet ose transmetohet në asnjë formë, mekanike ose elektronike, përfshirë fotokopjimin ose ndonjë material tjetër të sistemit të ruajtjes dhe rikthimit, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jo-komerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate ose materiale të ndryshme të këtij botimi është i detyruar të sqarojë burimin nga i cili ka marrë ato citime ose materiale të përdorura.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë ose sugjerim, ju lutemi na kontaktoni përmes opsioneve të dhëna më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr.239.
10,000, Prishtinë, Kosovë.
Tel: +383 (0) 38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.demokracianeveprim.org

Përgatitur nga: Demokracia në Veprim (DnV)

Dizajn: ENVINION

Ky raport u realizua në kuadër të misionit të "Demokracisë në Veprim" për vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit 2025. Misioni dhe komponentët e tij janë realizuar me mbështetjen financiare të Ambasadës Zvicerane në Kosovë, Zyrës së Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit (FCDO), si dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Çeke në kuadër të Programit për Promovimin e Tranzicionit.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Demokracia në Veprim (DnV) dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e donatorëve.

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
HYRJE	8
METODOLOGJIA	9
KONTEKSTI DHE PARAFUSHATA ZGJEDHORE	10
TË GJETURAT NGA MONITORIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE	13
AKTIVITETET ZGJEDHORE SIPAS SUBJEKTEVE POLITIKE, KOMUNAVE DHE FORMAVE TË ORGANIZIMIT	14
PJESËMARRJA E QYTETARËVE DHE GJITHËPËRFSHIRJA	17
SHFRYTËZIMI I RESURSEVE PUBLIKE PËR QËLLIME ELEKTORALE	18
MESAZHET POLITIKE DHE PËRMBAJTJA E FJALIMEVE	19
PËRDORIMI I GJUHËS NXITËSE DHE TË URREJTJES	21
SHPENZIMET NË AKTIVITETET E FUSHATËS	22
ATMOSFERA DHE SIGURIA	24
MBULUESHMËRIA E AKTIVITETEVE NGA MEDIAT	25
FUSHATA NË RRJETET SOCIALE	26
ANKESAT NË PZAP DHE VENDIMET PËR SHKELJET GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE	28
REKOMANDIME	30

Përmbledhje Ekzekutive

Ky raport ofron një pasqyrë të gjetjeve nga monitorimi i fushatës zgjedhore nga Demokracia në Veprim (DnV) për zgjedhjet parlamentare të mbajtura me 9 shkurt 2025, në cilat garuan 28 subjekte politike me gjithsej 1,280 kandidatë. Në këtë garë, kishim për herë të parë 6 subjekte politike nga komuniteti serb, duke diversifikuar mundësitë e zgjedhjes brenda këtij komuniteti.

Në mungesë të rregullimit dhe kufizimeve ligjore, fushatës zgjedhore zyrtare i parapriu një parafushatë intensive brenda dhe jashtë vendit, me aktivitete në terren dhe kampanja në rrjetet sociale. Vendimet qeveritare dhe vendimet e ndërmarra nga ekzekutivët në nivel lokal në këtë periudhë ngritën shqetësime për ndikim në orientimin e votës së qytetarëve. Subjektet politike përgjithësisht paralajmëruan aktivitetet publike pranë Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ) në përputhje me dispozitat ligjore, ndërsa vetëm në 4% të rasteve aktivitetet u mbajtën pa paralajmërim paraprak.

Komunat e mëdha ishin fokusi kryesor për organizimin e aktiviteteve nga subjektet politike, me 36% të të gjitha tubimeve publike, që u mbajtën në Prizren, Prishtinë, Pejë, Gjiilan dhe Mitrovicë të Jugut. Në perspektivë numerike, në mesin e subjekteve të mëdha politike, më së shumti tubimet publike organizuan Partia Demokratike e Kosovës (rreth 27% e numrit të përgjithshëm të tubimeve publike), Lidhja Demokratike e Kosovës (rreth 26% e numrit të përgjithshëm të tubimeve publike), nga Lëvizja Vetëvendosje (rreth 21% e numrit të përgjithshëm të tubimeve publike) si dhe koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës – NISMA [dhe të tjerat] (rreth 15% e numrit të përgjithshëm të tubimeve publike).

Fushata zgjedhore u karakterizua me një pjesëmarrje aktive të qytetarëve dhe një angazhim të lartë të subjekteve politike për të promovuar platformat e tyre dhe për të arritur besimin e elektoratit. Ky angazhim u shpreh në zhvillimin e aktiviteteve të shumta publike, takimeve derë më derë dhe përdorimin e mediave sociale si një mundësi për të arritur më shumë qytetarë.

Megjithatë, kjo fushatë gjithashtu u shoqërua me disa problematika që kërkojnë vëmendje për të siguruar një proces zgjedhor të drejtë dhe të paanshëm. Në gjithsej 779 aktivitete të monitoruara nga DnV morën pjesë afërsisht 152,575 qytetarë, me një mesatare prej rreth 200 pjesëmarrës në një ngjarje. Shumica e ngjarjeve u mbajtën në hapësira publike (74%), ku në 17% të rasteve nuk pati infrastrukturë të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara. Tubimet u karakterizuan me pjesëmarrje të ulët të grave, të cilat mesatarisht përbënin vetëm 14% të numrit të përgjithshëm të pjesëmarrësve, ndërsa rreth 27% e numrit të përgjithshëm të folëse në fushatë. Në rreth 2% të rasteve u raportua për prezencë të organizuar të fëmijëve, në kundërshtim me ligjin.

Tubimet e partive u karakterizuan me produkte të llojllojshme, shërbime dhe transport të organizuar për pjesëmarrësit, indikatorë që treguan për shpenzime të mëdha nga subjektet politike, të cilat ishin vështirë të matshme.

Për më tepër, ka pasur edhe raste të përdorimit të resurseve publike, si vendimet qeveritare e komunale para dhe gjatë fushatës me tendencë orientimin e votës së qytetarëve. Ndonëse në masë të vogël, edhe përdorimi i veturave zyrtare dhe shërbyesve publik u evidentua në dhjetëra aktivitete (3% e rasteve). Këto janë mangësi që kërkojnë zgjidhje për të siguruar barazi mes subjekteve politike dhe për të ruajtur integritetin e procesit zgjedhor.

Fjalimet politike kishin në fokus çështje programatike si arsimit, ekonomia, punësimi dhe pagat, shëndetësia, mirëqenia sociale, infrastruktura, kultura, rinia dhe sporti, dhe drejtësia e sundimi i ligjit. Por shumë prej propozimeve ishin të paqarta në lidhje me mundësitë e realizimit dhe financimin.

Njëra nga shqetësimet kryesore ishte përdorimi i gjuhës nxitëse dhe të urrejtjes nga subjektet politike,

që kontribuoi në një atmosferë të tensionuar, duke shkelur parimet themelore të një procesi demokratik. Ky fenomen është i dëmshëm për unitetin shoqëror dhe mund të ndikojë në besimin e qytetarëve tek procesi zgjedhor. Gjuha nxitëse dhe e urrejtjes ishte prezente në shumë prej tubimeve publike, konkretisht në 17% të rasteve, fenomen ky për të cilin subjektet politike morën një numër të madh të gjobave nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP). Në përqindje, Lëvizja Vetëvendosje prin sa i përket aktiviteteve të zhvilluara ku ka pasur gjuhë të urrejtjes – me mbi 20% të aktiviteteve.

Partitë opozitare, përfshirë PDK, LDK¹ dhe AAK publikuan programet, duke filluar nga muaji shtator dhe dhjetor 2024. Paraprakisht ato kishin zhvilluar takime dhe diskutime me qytetarë nëpër komuna, për të identifikuar kërkesat e tyre. Në anën tjetër, LVV publikoi me vonesë programin e saj, konkretisht në gjysmën e dytë të fushatës, në formatin e një dokumenti zotimesh. Në përgjithësi, atmosfera e fushatës ishte e qetë, me disa incidente të izoluara ku u hodhën mjete piroteknike, koktejt molotovi dhe grisje e posterëve, në komuna si Skënderaj, Graçanicë, dhe komunat veriore. Këto ngjarje u kritikuan për cenim të lirisë së grumbullimit dhe parimeve të demokracisë. Policia ishte ajo që u përkujdes për shumicën e tubimeve publike, gjithsej 604 tubime, për 53 tubime u përkujdesen kompanitë private të sigurimit, kurse në 160 tubime nuk pati fare sigurim.

Raportet e subjekteve politike me mediat ishin të ndryshme, me partinë në pushtet e cila bojkotoi pjesëmarrjen në disa medime dhe hodhi akuza për qasje të një anshme. Në disa raste të izoluara, mediat u penguan për të përcjellë aktivitetet publike, ndërsa ishin prezente në 39% të aktiviteteve të fushatës.

Subjektet politike shfrytëzuan edhe platformat sociale për zhvillim të fushatës, me 8,000 postime të sponsorizuara dhe një shpenzim total prej 200,000 eurosh, ku kryesoi kandidati për Kryeministër i LDK-së dhe ai i PDK-së. Ngjashëm, edhe kjo hapësirë mbeti sfiduese

për identifikim të plotë të shpenzimeve dhe financimit të subjekteve politike.

Fushata zgjedhore u karakterizua me një numër të madh të shkeljeve, gjë që rezultoi me gjithsej 450 ankesa që u parashtruan në PZAP, për përdorimin e resurseve publike, përdorimin e gjuhës nxitëse dhe urrejtëse, përfshirjen e fëmijëve në aktivitete politike, vendosjen e posterëve në vende të palejuara etj. Për këto PZAP nxori 149 vendime me anë të të cilave shqiptoi gjoba ndaj subjekteve politike në vlerë prej 612,100 Euro. Më së shumti gjoba u shqiptuan ndaj partisë në pushtet LVV, pasuar nga PDK, LDK dhe AAK-NISMA. Disa dallime në gjoba për shkelje të ngjashme ngritën pikëpyetje për objektivitetin e PZAP-së, ngjashëm edhe atë të Gjykatës Supreme si shkallë e dytë e ankimit. Kjo situatë theksoi nevojën për përmirësimin e koherencës në vendimmarrje, interpretimit të qartë dhe të barabartë të ligjit, për një zbatim të drejtë të tij për të gjitha subjektet politike.

1 Programi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, i quajtur "Ruga e Re" ishte publikuar për herë të parë qysh në dhjetor të vitit 2023, mbi një vit para procesit zgjedhor.

Hyrje

Ky raport paraqet të dhëna të mbledhura nga monitorimi i fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, realizuar nga vëzhguesit afatgjatë të koalicionit Demokracia në Veprim (DnV). Objektivi kryesor i këtij raporti është të ofrojë një vlerësim të hollësishëm të zhvillimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e 9 shkurtit 2025 dhe të identifikojë faktorët që kanë ndikuar në mënyrën se si ajo ka ecur. Raporti është i strukturuar në disa pjesë, ku paraqitet përshkrimi i metodologjisë dhe strukturës së përdorur për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, si dhe mënyra e trajtimit të raporteve nga vëzhguesit në terren për të siguruar një proces të besueshëm dhe të sistematizuar monitorimi.

Një pjesë e rëndësishme e raportit është analizimi i periudhës së parafushatës dhe aspektet e organizimit të zgjedhjeve nga subjektet politike, duke pasur parasysh mungesën e kufizimeve ligjore. Pjesa kryesore e raportit i është dedikuar analizës së zhvillimeve të fushatës zgjedhore, ku janë trajtuar aktivitetet e subjekteve politike sipas komunave dhe formave të organizimit, si dhe pjesëmarrja e qytetarëve dhe angazhimi i tyre në procesin zgjedhor. Raporti gjithashtu fokusohet në evidentimin e përdorimit të resurseve publike, përfshirë veturat zyrtare dhe angazhimin e shërbyesve publikë. Po ashtu, raporti ofron një vlerësim mbi mesazhet politike dhe përmbajtjes së fjalimeve, me theks në përdorimin e gjuhës nxitëse dhe asaj të urrejtjes.

Gjithashtu, raporti shqyrton shpenzimet për aktivitetet publike, si dhe mbulimin e aktiviteteve nga mediat, përdorimin e rrjeteve sociale dhe ndërveprimin e subjekteve politike me publikun. Në përfundim, raporti ofron rekomandime për përmirësimin e fushatave zgjedhore në të ardhmen, duke theksuar rëndësinë e një procesi të rregullt, të barabartë dhe të besueshëm për të siguruar një demokraci funksionale dhe të drejtë.

Metodologjia

Demokracia në Veprim (DnV) ka realizuar monitorimin e fushatës zgjedhore përmes angazhimit të 44 vëzhguesve në terren, të cilët kanë ndjekur aktivitetet e subjekteve politike, përkatësisht tubimet publike, në 38 komunat e Kosovës për periudhën nga 11 janari deri më 8 shkurt 2025.

Përgjithësisht, informacionet e përdorura në këtë raport janë të dhëna primare të mbledhura direkt nga terreni dhe rrjetet sociale, ndërsa një pjesë e vogël e të dhënave dhe citimeve janë të natyrës sekondare. Vëzhguesit kanë monitoruar zhvillimet e fushatës zgjedhore dhe kanë raportuar çdo ditë për ngjarjet që kanë ndjekur, takimet me subjektet politike, mbledhjet e Këshillave Komunal Zgjedhor (KKZ) dhe parregullsitë që kanë vërejtur gjatë periudhës së fushatës.²

Vëzhguesit e DnV-së kanë marrë pjesë gjithashtu në mbledhjet e rregullta të KKZ-ve për të marrë informacion mbi ngjarjet e paralajmëruara nga subjektet politike, në mënyrë që të ndjekin këto ngjarje dhe të raportojnë nëse ato janë deklaruar si të tilla nga subjektet politike në KKZ. Demokracia në Veprim ka zhvilluar edhe intervista me përfaqësues të subjekteve politike, për të marrë opinionet dhe vlerësimet e tyre lidhur me zhvillimin e fushatës zgjedhore.

² Vëzhguesit e DnV-së kanë përdorur formularë standard për monitorim, të cilat janë plotësuar dhe dërguar përmes një databaze online të krijuar për këtë fushatë, së bashku me të dhënat personale dhe fotografitë përkatëse për verifikim dhe përpunim të të dhënave

Konteksti dhe parafushata zgjedhore

Pas një serie të konsultimeve me partitë politike, dhe në përputhje me afatet ligjore, me 16 gusht 2024, Presidentja e vendit Vjosa Osmani, shpalli datën 9 shkurt 2025, si datë për mbajtjen e zgjedhjeve të rregullta parlamentare për Kuvendin e Kosovës.³ Kjo ishte hera e parë që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës që vendi organizoi zgjedhje në afate të rregullta, pasi zgjedhjet parlamentare paraprake kishin qenë të parakohshme.

Një javë pas shpalljes së dekretit të Presidentes, KQZ miratoi planin e aktiviteteve për organizimin e zgjedhjeve. Po ashtu edhe vendosi për kufizimin e shpenzimeve të fushatës së zgjedhjeve për subjektet politike garuese – të cilat kanë të drejtë të shpenzojnë deri në 2,047,149 euro, pra 1 euro për votues të regjistruar.⁴ Risi e kësaj fushate ishte që do të zhvillohej nën ndryshimet ligjore në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike.

Më 31 dhjetor 2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) certifikoi 28 subjekte politike dhe 1,280 kandidatë, të cilët do të garonin në zgjedhjet e 9 shkurtit. KQZ miratoi aplikimet e të gjitha subjekteve, përveç Listës Serbe, për të cilën vendimi i refuzimit shkaktoi një debat të gjerë dhe ngriti shqetësime për barazimin në garën zgjedhore. KQZ e refuzoi këtë certifikim kundërligjshëm, pavarësisht rekomandimit të Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike. Më pas, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe Gjykata Supreme e korrigjuan vendimin e KQZ-së dhe e certifikuan subjektin, duke pasqyruar ndikimin e konsideratave politike mbi parimet ligjore në disa aspekte të administrimit të zgjedhjeve.

Fushata zgjedhore që iu parapriu zgjedhjeve të 9 shkurtit, u zhvillua në një këtë kontekst politik të ndërlikuar, të karakterizuar nga përplasjet mbi qeverisjen, marrëdhëniet ndëretnike dhe sfidat e integritetit euroatlantik të vendit. Këta faktorë ndikuan në debatin politik dhe në atmosferën e përgjithshme të fushatës, duke ndikuar edhe në diskursin dhe narrativet kryesore të akterëve politik gjatë garës zgjedhore.

Mungesa e një kornize ligjore për para fushatën zgjedhore në Kosovë krijoi mundësi për aktivitete elektorale të hershme, duke u lejuar partive politike të përdorin kanale fleksibile komunikimi me votuesit dhe të kombinonë aktivitetet politike me ato zgjedhore. Kjo reflektoi në përdorimin e strategjive të ndryshme, si aktivitete në terren, takime me struktura të partive, dhe fushata digjitale.

Një fenomen i dukshëm ka qenë dominimi i eksponentëve politikë në debatet televizive, sidomos nga opozita, e cila përdori këtë hapësirë për të sfiduar qeverinë. Në anën tjetër, Lëvizja Vetëvendosje orientoi parafushatën kryesisht jashtë Kosovës, duke u fokusuar në diasporë për të ruajtur dhe rritur mbështetjen që kishte fituar gjatë zgjedhjeve të vitit 2021, ndërsa partitë opozitare, si PDK dhe LDK, përdorën një qasje më tradicionale për angazhimin me qytetarët përmes takimeve dhe fushatës derë më derë.

Në këtë periudhë pati përplasje mes pozitës dhe opozitës, ku partitë opozitare vunë në pah dëshimet e qeverisë, ndërsa LVV vazhdoi me narrativën e ndërlidhjes së subjekteve të tjera politike me fenomenin e korrupsionit. Kjo krijoi një debat polarizues dhe vështirësoi diskutimin e propozimeve të argumentuara.

3 Shih dekretin e Presidentes për shpalljen e datës së zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025, në <https://shorturl.at/H7yyp>

4 Shih vendimet e KQZ-së së datës 23 gusht 2024 në <https://shorturl.at/b2maS>

Një element tjetër i rëndësishëm gjatë kësaj periudhe ka qenë ndërhyrja e qeverisë përmes masave financiare me ndikim social, të cilat kanë ngritur shqetësime për mundësinë e përdorimit të resurseve publike për qëllime elektorale. Vendime të tilla si rritja e pensioneve për grupe të ndryshme, rritja e pagës minimale dhe shpërndarja e ndihmave financiare për shtresa të caktuara të popullsisë, ndonëse në dukje si masa të drejta sociale, kanë shkaktuar debate mbi ndikimin e mundshëm të këtyre veprimeve në procesin zgjedhor dhe mbi motivet politike që mund të fshihen pas tyre. Më e diskutueshmja mbetet shpërndarja e 100 eurove për rreth 700,000 qytetarë në prag të festave të fundvitit, e cila është interpretuar si një tentativë për të ndikuar në elektorat në periudhën e zgjedhjeve.⁵

Po ashtu, përfshirja e Kryeministrit Kurti në ceremoninë e ndarjes së "kartelave të punës" për punësimin e rinjve në KEK dhe promovimi i projekteve qeveritare gjatë kësaj periudhe kanë krijuar perceptimin se fushata elektorale po mbështetet në burime shtetërore, një praktikë që bie në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të barazisë në garën zgjedhore.⁶

Në nivel lokal, janë vërejtur raste të shfrytëzimit të projekteve komunale për qëllime elektorale, përfshirë prerjen e shiritave dhe inaugurimin e investimeve publike para zgjedhjeve, një taktikë e përdorur edhe në të kaluarën. Këto praktika ngritën shqetësime për integritetin e procesit zgjedhor dhe mundësinë e ndikimit indirekt të qeverisë tek zgjedhësit përmes ofrimit të përfitimeve financiare dhe ekonomike.

Në përfundim, parafushata zgjedhore në Kosovë mbetet një periudhë e pa rregulluar me ligj, pa ndarje të qartë nga fushata zyrtare, duke krijuar ambient të pabarabartë për partitë politike garuese.⁷ Përdorimi i burimeve shtetërore dhe mungesa e rregullimit ligjor mbeten çështje të rëndësishme që duhet adresuar për të siguruar një proces zgjedhor të drejtë dhe transparent.

5 Kallxo, "Një ditë para fillimit të fushatës zgjedhore, Qeveria rrit pensionet për kategoritë e dala nga lufta", 10 janar 2025, në <https://kallxo.com/lajm/nje-dite-para-fillimit-te-fushates-zgjedhore-qeveria-rrit-pensionet-per-kategorite-e-dala-nga-lufta/>

6 Gazeta Express "Kartela 220 punëtorëve të rinj në KEK, a po bën fushatë? Kurti: Kjo është në funksion të mihjes, qymyrit" në, <https://www.gazetaexpress.com/kartela-220-punetoreve-te-rinj-ne-kek-a-po-ben-fushate-kurti-kjo-eshte-ne-funksion-te-mihjes-qymyrit/>

7 Shih më shumë në publikimin e DNV-së "Trendet e parafushatës dhe respektimi i standardeve", në https://demokracianeveprim.org/wp-content/uploads/2025/01/PDF_Trendet-e-parafushates-dhe-zbatimi-i-standardeve-nentor-2024-janar-2025.pdf



TË GJETURAT NGA MONITORIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE

Fushata zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit filloi me 11 janar 2025 dhe zgjati gjithsej 30 ditë, deri në hapje të vendotimeve më 9 shkurt 2025. Për dallim nga proceset zgjedhore të kaluara, kjo fushatë nuk u karakterizua me ditën e heshtjes zgjedhore. Prandaj, subjektet politike vazhduan të zhvillojnë aktivitete edhe një ditë para ditës së zgjedhjeve.

DnV me anë të vëzhguesve afatgjatë monitoroi aktivitetet publike të subjekteve politike në të gjitha komunat e Kosovës, duke përfshirë format e organizimit, pjesëmarrjen e qytetarëve dhe gjithëpërfshirjen, përdorimin e veturave zyrtare dhe praninë e shërbyesve publik në fushatë, mesazhet politike dhe përmbajtjen e fjalimeve, përdorimin e gjuhës nxitëse dhe të urrejtjes, transparencën financiare dhe shpenzimet në aktivitete publike, mbulueshmërinë e aktiviteteve nga mediat si dhe atmosferën dhe sigurinë gjatë aktiviteteve të fushatës. Më poshtë janë të paraqitura të dhënat e detajuara lidhur me këto komponentë.

Aktivitetet zgjedhore sipas subjekteve politike, komunave dhe formave të organizimit

Gjatë fushatës zgjedhore, DnV ka monitoruar gjithsej 779 aktivitete zgjedhore, 96% e të cilave janë raportuar paraprakisht në Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ). Megjithatë, 4% e tubimeve nuk janë njoftuar, praktikë kjo në kundërshtim me Rregulloren Zgjedhore Nr. 07/2024, Neni 4, ku përcaktohet që subjekti politik duhet të dorëzojë formularin për njoftim për tubim 24 orë para tubimeve me më pak se 200 pjesëmarrës dhe 48 orë para tubimeve me më shumë se 200 pjesëmarrës.⁸


Aktivitetet zgjedhore të subjekteve politike të cilat DnV i ka monitoruar përfshijnë tubimet publike, ndërsa subjektet politike kanë zhvilluar edhe aktivitete tjera të fushatës si takime me grupe të shënjestruara, shtande dhe vizita derë-më-derë. Këto të fundit ka qenë e vështirë për t'u monitoruar nga vëzhguesit, sepse nuk janë raportuar në organet përkatëse.

Sa i përket shtrirjes së aktiviteteve publike nëpër komuna, subjektet politike fokusuan mbajtjen e tubimeve në komuna më të mëdha si Prizreni, Prishtina, Peja, Gjilani, Mitrovica e Jugut, dhe Gjakova, ku në secilën u monitoruan më shumë se 30 tubime. Këto komuna janë qendra të rëndësishme urbane dhe politike, ku subjektet politike panë mundësi për të arritur një numër të madh votuesish dhe të shtojnë shanset për të fituar mbështetje.

Nga ana tjetër, në komunat me shumicë serbe dhe disa komuna të tjera më të vogla, si Fushë Kosova, Lipjani, Kamenica, Kaçaniku dhe Viti, aktivitetet zgjedhore ishin më të pakta, ku u monitoruan më pak se 20 tubime të mbajtura. Kjo mund të lidhet me faktorë të ndryshëm, përfshirë numrin e ulët të votuesve dhe mundësitë më të kufizuara për organizimin e aktiviteteve.

⁸ Shih Rregullën Zgjedhore të KQZ-së <https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2024/10/Rregullore-Zgjedhore-Nr.-07-2024.pdf>


FIGURA 1 Numri i tubimeve të subjekteve politike sipas komunave



Në aspekt krahasimtar mes subjekteve politike, sa i përket numrit të aktiviteteve të monitoruara gjatë fushatës, ka prirje PDK me gjithsej 207 tubime të organizuara, pasuar nga LDK me 203, LVV me 163 dhe Koalicioni i AAK-NISMA

me 114 tubime. Ndërsa, nga subjektet politike të komunitetit serb, ka qene Lista Serbe ajo e cila ka mbajtur më së shumti tubime publike në krahasim me subjektet tjera në garë, me gjithsej 24 tubime të organizuara gjatë fushatës.

FIGURA 2 Numri i tubimeve të subjekteve politike sipas komunave



Në nivel komunal, subjektet politike organizuan tubime në pothuajse të gjitha komunat, por me një përqendrim më të lartë të tubimeve aty ku përqendrohej shumica e elektoratit mbështetës. LVV zhvilloi më shumë aktivitete në komunat e Prizrenit dhe Mitrovicës së Jugut, LDK në komunat e Gjilanit dhe Prishtinës, PDK në

Prizren dhe Prishtinë, ndërsa koalicioni i AAK-NISMA organizoi më shumë tubime në komunat e Deçanit dhe Malishevës. Ndërsa, meqë fushata ishte 30 ditore, subjektet politike patën mundësi që në shumicën e komunave të organizojnë aktivitete më shumë se një herë.

Pjesëmarrja e qytetarëve dhe gjithëpërfshirja

Sa i përket pjesëmarrjes qytetare, interesimi i tyre për të marrë pjesë në tubime ishte mjaft i lartë. Gjatë fushatës 30 ditore, në tubimet e subjekteve politike morën pjesë rreth 152,575 qytetarë, ku mesatarisht kishte 196 pjesëmarrës për tubim. Tubimet u organizuan kryesisht në objekte publike, me 74% e aktiviteteve të mbajtura në këto hapësira. Pjesa tjetër (26%) e tubi-

meve u mbajtën edhe në objekte private – përfshirë restaurantet, hotelet apo sallat tjera private. Qasja për personat me aftësi të kufizuara ishte e mundur në 83% të aktiviteteve të monitoruara, ndërsa në 17% të rasteve në objektet ku po mbahej tubimi qasja ishte e vështirë apo e pamundur për këtë kategori të pjesëmarrësve.

FIGURA 3 Përqindja e tubimeve sipas numrit të qytetarëve të pranishëm





FIGURA 4 Numri e tubimeve sipas numrit të qytetarëve të pranishëm



Përfshirja dhe përfaqësimi i grave edhe gjatë kësaj fushate zgjedhore ishte relativisht i ulët. Subjektet politike ndonëse kanë bërë premtime për të ofruar mundësi më të mëdha për gratë, kjo nuk është reflektuar në praktikë. As avancimi i legjislacionit nuk ka rezultuar në rritje të numrit të grave të përfshira në fushatën zgjedhore. Gjatë fushatës ka pasur një hendek të dukshëm mes grave dhe burrave si në aspekt të përfshirjes ashtu edhe si folës në këto aktivitete.

Në 779 tubime të mbajtura nga subjektet politike, vetëm rreth 14% e numrit të përgjithshëm të pjesëmarrësve ishin gra. Ndërsa, mes kandidatëve që mbajtën fjalime gjatë fushatës, vetëm 27% e tyre ishin gra. Për më tepër, gratë kandidate u përballën me një numër të lartë sulmesh të drejtpërdrejta në hapësirat online, një prirje që tregon sfidat e vazhdueshme në sigurimin e një mjedisi të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor.


Shfrytëzimi i resurseve publike për qëllime elektorale

Legjislacioni në fuqi ndalon përdorimin e resurseve publike, financiare dhe njerëzore nga subjektet politike në pushtet, pasi përdorimi i këtyre resurseve krijon avantazhe të padrejta dhe çrregullon parimin e garës së barabartë mes subjekteve politike. Sipas ligjit, përcaktohet që *"Përdorimi i zyrave publike, burimeve ose personelit të cilitdo institucion në nivel qendror ose lokal, me qëllim mbështetjeje të një subjekti politik në zgjedhje, është rreptësisht i ndaluar"*. Më tutje në të njëjtin nen thuhet se, *"subjektet politike nuk mund të shfrytëzojnë nëpunësit civilë që përdorin pozitën, burimet, ose personelin për fushatë gjatë zgjedhjeve"*.

Vëzhguesit e DnV-së kanë evidentuar raste kur subjektet politike kanë përdorur veturat zyrtare dhe shërbysit publik për qëllime elektorale. Në të paktën 25 aktivitete është vërejtur prani e veturave zyrtare, në 4 raste të nivelit qendror kur janë mbajtur aktivitete nga partia në pushtet, kurse në 22 raste kur aktivitetet janë organizuar nga partitë tjera kryesisht nga LDK në 11 aktivitete, AAK në 7 aktivitete, si dhe PDK në 1 aktivitet – në komunat ku këto parti qeverisin. Ky vit ka shënuar një përparim të dukshëm krahasuar me zgjedhjet parlamentare të vitit 2021, kur përdorimi i veturave zyrtare është evidentuar në gjithsej 38 aktivitete.

Ndërsa, në 23 aktivitete është raportuar për prani të zyrtarëve publik, prej të cilave, 11 ishin aktivitete të organizuara nga PDK, 8 aktivitete të LDK-së, si dhe nga 2 aktivitete të LVV-së dhe koalicionit AAK-NISMA. konkretisht në 2 aktivitete të organizuara nga partia në pushtet LVV dhe në 21 raste në aktivitetet e partive tjera, Ndërsa, sa i përket prezencës së shërbysve publik, është vërejtur një dallim jo i theksuar krahasuar me zgjedhjet e vitit 2021, ku janë evidentuar 19 raste të pjesëmarrjes së shërbysve publikë në fushatë.

% e tubimeve ku ka pasur prani të veturave zyrtare



% e tubimeve ku ka pasur prani të zyrtare publik




Mesazhet politike dhe përmbajtja e fjalimeve

Një aspekt pozitiv i kësaj fushate ishte rritja e vëmendjes së subjekteve politike ndaj çështjeve programore, duke reflektuar një përpjekje më të strukturuar për të adresuar temat që janë të rëndësishme për qytetarët. Pavarësisht rasteve të gjuhës së urrejtjes dhe diskursit polarizues, debatet politike, në përgjithësi, treguan një nivel të shtuar të diskutimeve mbi çështje konkrete si arsimi, ekonomia, mirëqenia sociale, siguria dhe mbrojtja. Një tipar dallues i kësaj fushate ishte ndarja e qartë e prioritetëve mes partisë në pushtet dhe partive opozitare. Derisa Lëvizja Vetëvendosje e orientoi narrativën e saj kryesisht rreth çështjeve të sovranitetit dhe integritetit territorial, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë veriut të vendit, partitë opozitare u përqendruan më shumë në problematikat ekonomike, si dhe çështjes së arsimit, duke ofruar alternativa për zhvillimin dhe rimëkëmbjen e vendit. Megjithatë, për disa prej propozimeve, ndonëse të njëjtat tingëlluan tërheqëse dhe të dobishme, shpeshherë kanë munguar detajet për planet e zbatimit të tyre. Ka pasur pak diskutime mbi burimet e mundshme të financimit dhe mënyrat konkrete për të adresuar sfidat e përmendura nga subjektet politike gjatë fjalimeve të tyre. Pa një qasje të detajuar dhe një plan konkret për implementimin e këtyre propozimeve, është e vështirë të vlerësohet nëse ato do të mund të realizohen dhe të japin rezultatet që premtojnë.

Subjektet politike më të mëdha në garë, PDK, LDK dhe AAK, , publikuan para fushatës programet politike në faqet e tyre zyrtare. Ky ishte një hap pozitiv, pasi siguroi transparencë dhe mundësoi që qytetarët të kenë qasje në informacionin e nevojshëm për të bërë zgjedhjen më të informuar. Nga ana tjetër, LVV publikoi me vonesë programin zgjedhor, tek në javën e dytë të fushatës, ndonëse kishte premtuar që do ta publikonte në fillim të saj. Ndryshe prej një programi të mirëfilltë zgjedhor, ky dokument ishte një listë e zotimeve për veprime që do të ndërmerreshin në sektorë të ndryshëm të vendit.

FIGURA 5 Temat/çështjet që ishin pjesë e fjalimeve gjatë fushatës



Përdorimi i gjuhës nxitëse dhe të urrejtjes

Një nga elementet më të dukshme të kësaj fushate ka qenë përdorimi i gjuhës nxitëse dhe të urrejtjes nga subjektet politike dhe kandidatët e tyre. Gjatë periudhës së fushatës, shpesh janë regjistruar sulme të ndërsjella, akuza personale dhe përdorimi i termave denigrues, duke krijuar një atmosferë polarizuese që minon integritetin e një gare të drejtë dhe demokratike. Ky fenomen ishte i pranishëm si në tubimet elektorale, ashtu edhe në platformat digjitale, ku u vërejt një rritje e rasteve të përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe fyerjeve. Vëzhguesit e DnV-së kanë raportuar dhjetëra raste ku subjektet politike kanë përdorur këtë lloj gjuhe, duke etiketuar kandidatë dhe subjekte të tjera në garën zgjedhore. Kjo gjuhë ka pasur një natyrë kryesisht politike dhe personale, me disa raste kur është bërë thirrje për të mos votuar për individë apo subjekte të caktuara.,

Përdorimi i gjuhës së urrejtjes është evidentuar në 129 tubime të subjekteve politike, që përbëjnë 17% të gjithëj aktiviteteve të fushatës. Në perspektivë krahasuese, kjo gjuhë ka qenë e pranishme në nivele të ngjashme në të gjitha partitë, si të pushtetit ashtu edhe të opozitës, por me një dominim në aktivitetet e partisë në pushtet. Specifikisht, gjuha nxitëse apo e urrejtjes është hasur në 21% të tubimeve të LVV-së, 17% të LDK-së, 14% të aktiviteteve të PDK-së dhe 20% të AAK-së.

Për më tepër, ky fenomen është reflektuar edhe në vendimet e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i cili shqiptoi një numër të konsiderueshëm gjobash në vlerë gjithsej 360 mijë euro, për rastet ku u përdor gjuha e urrejtjes. Për herë të parë, PZAP filloi të shqiptojë ndëshkime edhe për shkeljet e supozuara nga mbështetësit e subjekteve politike, të cilët përdorën gjuhë të tillë, si në tubime në terren ashtu edhe në rrjetet sociale.

Përdorimi i gjuhës nxitëse është i ndaluar me legjislacionin në fuqi. Sanksionimi i kësaj gjuhe është parashikuar në Nenin 34 të Ligjit për Zgjedhjet, i cili përcakton veprimet e ndaluara për subjektet politike gjatë procesit zgjedhor, duke e bërë të qartë se përdorimi i gjuhës së urrejtjes nuk tolerohet dhe duhet të ndiqet me ndëshkime për të siguruar një proces zgjedhor të drejtë dhe të pa favorizuar.⁹

⁹ Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, në <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=77074>


Shpenzimet në aktivitetet e fushatës

Monitorimi i fushatës zgjedhore ka përfshirë gjithashtu shpenzimet e partive politike garuese për organizimin e aktiviteteve të ndryshme zgjedhore.

Një javë pas shpalljes së dekretit të Presidentes, me 21 gusht 2024, KQZ vendosi për kufizimin e shpenzimeve të fushatës së zgjedhjeve për subjektet politike garuese, të cilat do të certifikoheshin për pjesëmarrje në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës. Sipas këtij vendimi u përcaktua që një subjekt politik kishte të drejtë të shpenzonte deri në rreth 2 milion euro, pra 1 euro për votues të regjistruar.¹⁰

Gjatë monitorimit të aktiviteteve zgjedhore, DnV ka identifikuar dhe evidentuar disa elemente që përbëjnë shpenzime financiare gjatë fushatës. Një prej aspekteve më të dukshme ka qenë shpërndarja e materialeve promovuese, si kartëvizita, broshura dhe rekuizita të ndryshme, të cilat janë shpërndarë në numër të konsiderueshëm. Ky lloj shpërndarjeje mund të konsiderohet si një metodë e zakonshme për të rritur ekspozimin e kandidatëve dhe partive politike.

FIGURA 6 Numri i tubimeve para dhe gjatë së cilave janë shpërndarë materialet/produktet e mëposhtme




¹⁰ Shih vendimet e KQZ-së së datës 23 gusht 2024 në <https://shorturl.at/b2maS>

Përveç materialeve promovuese, në shumë aktivitete zgjedhore është vërejtur shpërndarja e pijeve dhe ushqimeve, të cilat mund të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në motivimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në këto aktivitete. Përdorimi i shërbimeve të tjera, si zërimi,

shërbimet profesionale për video xhirime, binat dhe ndriçimi, gjithashtu ka shtuar ndjeshëm shpenzimet, duke përfshirë aktivitete që kërkojnë investime të konsiderueshme.

FIGURA 7 Numri i tubimeve ku janë përdorur shërbimet e mëposhtme



Në 22 raste, subjektet politike kanë ofruar transport të organizuar për pjesëmarrësit, një praktikë që mund të rrisë pjesëmarrjen në tubime, por gjithashtu mund të nënkuptojë përdorimin e këtij lloji shërbimi për qëllime elektorale.

Këto praktika tregojnë se fushatat zgjedhore vazhdojnë të karakterizohen nga një intensitet i lartë i shpenzimeve, shpesh përtej asaj që është e matshme apo e standardizuar brenda kuadrit të përcaktuar nga KQZ.

Atmosfera dhe siguria

Në përgjithësi atmosfera e fushatës zgjedhore ka qenë kryesisht e qetë. Megjithatë janë shënuar disa incidente të izoluar gjatë periudhës së fushatës, duke ngritur shqetësime mbi respektimin e standardeve demokratike. Rastet kryesore të incidenteve përfshijnë hedhjen e mjeteve të forta dhe atyre piroteknike në një tubim të mbajtur nga Lëvizja Vetëvendosje në Skenderaj¹¹, djegien e materialeve propaganduese të kandidatëve, si dhe disa incidente në komunat me shumicë serbe, të

tilla si pengimi i aktiviteteve elektorale në Graçanicë, hedhja e një kokteji molotovi mbi një veturë të KQZ-së dhe disa incidente të tjera në veri të vendit. Këto akte ishin sulme ndaj lirisë së grumbullimit dhe shprehjes së lirë, duke krijuar një atmosferë tensioni dhe pasigurie që binte në kundërshtim të plotë me parimet themelore të demokracisë.¹²



Sa i përket sigurisë së aktiviteteve të fushatës,

në 604 tubime,

për sigurinë e aktivitetit është përkujdesur policia.



në 53 tubime,

kompanitë private të sigurimit ndërsa,



në 160 tubime

nuk ka pasur fare sigurim.

¹¹ Koha Net, "Kurti kërkon votën në Drenicë mes hedhjes së mjeteve piroteknike", në <https://www.koha.net/arberi/tensione-prane-tubimit-te-kurti-ne-skenderaj-intervenon-policia>

¹² Shih komunikatën e DnV-së "Incidenti në Skënderaj cenon garën zgjedhore dhe lirinë e grumbullimit" në, <https://www.facebook.com/share/p/1FRX-mV7wSF/>


Mbulueshmëria e aktiviteteve nga mediat

Për periudhën sa zgjati fushata zgjedhore, peizazhi mediatik ishte i polarizuar, duke u karakterizuar nga dy zhvillime kryesore. Lëvizja Vetëvendosje mbajti një qasje vazhdimisht konfrontuese ndaj gazetarëve, madje duke bojkotuar disa medime; si dhe disa media u perceptuan si të njëanshme në mbulimin dhe raportimet e tyre. Ky veprim kufizoi ndjeshëm transparencën dhe krijoi pabarazi në qasjen e qytetarëve në informacion të balancuar mbi ofertat elektorale, duke ndikuar në cilësinë e debatit publik. Kryeministri dhe zyrtarët e partisë në pushtet përdorën një retorikë sulmuese ndaj mediave, duke i akuzuar për manipulim dhe ndikim negativ në opinionin publik.

Mediat ishin të pranishme në 39% të aktiviteteve të fushatës zgjedhore, veçanërisht në tubimet e mëdha ku ishin të pranishëm liderët e partive dhe përfaqësuesit e lartë partiak. Kryesisht, nuk kishte pengesa për mediat dhe organizatat e shoqërisë civile që të monitoronin dhe ndiqnin aktivitetet e fushatës. Megjithatë, pati disa raste të izoluara, veçanërisht ato të organizuara nga partia në pushtet, ku mediat u penguan në ushtrimin e punës së tyre nga vetë organizatorët e subjekteve politike, me pretendimin se mediat po publikonin qëllimisht pamje nga fillimi i tubimeve, kur pjesëmarrësit ende nuk kishin mbërritur, me qëllim që të krijohej përshypja se ato tubime ishin dështuar.

Zhvillimet gjatë fushatës në lidhje me mediat tregojnë se është e domosdoshme të balancohet nevoja për raportim të saktë me mbrojtjen e lirisë së mediave, duke siguruar që ato të mund të operojnë pa ndërhyrje të panevojshme, ndërkohë që të ruhet drejtësia dhe objektiviteti në pasqyrimin e ngjarjeve.

% e tubimeve në të cilat kanë qenë të pranishme mediat



Fushata në rrjetet sociale

Fushata e këtij viti ka sjellë një mobilizim të konsiderueshëm në rrjetet sociale, me një rritje të dukshme të numrit të postimeve të sponsorizuara dhe shpenzimeve për promovim digjital nga ana e partive dhe kandidatëve, me një shifër rekord të shpenzimeve prej 200 mijë euros. Ky rritje drastike e shpenzimeve reflekton një ndryshim të qartë në mënyrën e zhvillimit të fushatës, ku rrjetet sociale janë bërë mjetet kryesore të komunikimit elektoral, duke zëvendësuar në masë të madhe metodat tradicionale të promovimit.

Në javët e para të fushatës, të dhënat e monitoruara nga DnV kanë treguar një fillim të ngadalshëm të investimeve në sponsorizime në platforma digjitale. Në javën e parë, shpenzimet për sponsorizimet në Facebook dhe Instagram (Meta) ishin të kufizuara, me një total prej rreth 25,000 eurosh për mbi 1,000 postime. Ky fillim modest është pasuar nga një rritje e ndjeshme gjatë javës së dytë, kur shpenzimet u dyfishuan, duke arritur në gati 40,000 euro dhe numri i postimeve u rrit në rreth 2,000. Kjo rritje tregon se partitë po intensifikonin angazhimin e tyre në rrjetet sociale, për t'u përgatitur për një periudhë më të ngarkuar të fushatës.


Një avancim i madh në shfrytëzimin e rrjeteve sociale si mjet fushate, paralelisht me rritjen e shpenzimeve, kishte ndodhur në javën e tretë, kur shpenzimet ishin trefishuar në krahasim me javën e parë, duke arritur mbi 50,000 euro për 3,000 postime të sponsorizuara. Kjo rritje është shoqëruar me një intensifikim të shpenzimeve nga kandidatët kryesorë opozitarë, sidomos nga Lumir Abdixhiku (LDK) dhe Bedri Hamza (PDK), të cilat kishin shpenzuar mbi 12,000 euro secili. Shpenzimet e Lëvizjes Vetëvendosje, që deri atëherë ishin minimale, ishin rritur gjithashtu, duke reflektuar një ndryshim të strategjisë së fushatës dhe një angazhim më të madh për të arritur audiencat në rrjetet sociale.

Në përmbyllje të fushatës, DnV kishte identifikuar një rritje edhe më të madhe të shpenzimeve. Vlera e përgjithshme e shpenzimeve për tërë fushatën kishte arritur në 200,000 euro për rreth 8,000 postime sponsorizuara.

Në mesin e kandidatëve në garë zgjedhore, me shpenzimet më të larta për sponsorizime kryesoi Lumir Abdixhiku (LDK) me një total prej mbi 18,000 eurosh për 153 postime sponsorizuara. Pas tij, Bedri Hamza (PDK) shpenzoi mbi 17,000 euro për rreth 300 postime. Subjekti i komunitetit rom, Opre Roma Kosova, u rendit në vendin e tretë, duke shpenzuar 16,000 euro, duke treguar se partitë më të vogla gjithashtu kanë rritur investimet në rrjetet sociale.

Lëvizja Vetëvendosje, megjithëse kishte numrin më të madh të postimeve sponsorizuara (rreth 900 postime), shpenzoi një shumë më të vogël, rreth 14,000 euro. Kjo tregon një strategji më të fokusuar në volum, me një numër të madh postimesh që synonin mbërritjen e një audiencë më të gjerë, por duke u bazuar edhe në rrjetet e brendshme të aktivistëve që krijojnë shpërndarje organike.

FIGURA 8 Shpenzuesit më të mëdhenj në rrjetet sociale



Në fund, lista e shpenzuesve më të mëdhenj përfshin edhe emra si Memli Krasniqi (PDK), Ramush Haradinaj (AAK), si dhe disa kandidatë të tjerë të LDK-së dhe PDK-së, duke ilustruar një përpjekje të koordinuar për të maksimizuar ndikimin në rrjetet sociale. Specifikisht, kandidati i LDK-së, Krenar Xhaferi (me rreth 5,600 euro), kandidati i AAK-së, Egzon Kelmendi (me rreth 4 mijë euro), dhe kandidatja e PDK-së, Aurora Berisha (me 3,400 euro), përmbyllin listën e dhjetë shpenzuesve më të mëdhenj në rrjetet sociale për 30 ditët e fushatës. Shpenzimet e këtyre kandidaturave, ndonëse

paraqesin përpjekje për të rritur dukshmërinë e tyre dhe për të mobilizuar mbështetje të vazhdueshme, duhet të analizohen tutje në raport me raportimin financiar, duke ditur që kandidatët kanë obligim ligjor që të gjitha shpenzimet t'i kryejnë përmes xhirollogarisë së vetme bankare të subjektit politik. Në fakt, duke qenë se të shumica dërrmuese e shpenzimeve në rrjetet sociale janë bërë nga kandidatët, kjo duhet të trajtohet me seriozitet nga Zyra përkatëse për Kontroll Financiar brenda KQZ-së.

Ankesat në PZAP dhe vendimet për shkeljet gjatë fushatës zgjedhore

Gjatë fushatës zgjedhore, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka pranuar gjithsej 450 ankesa, të cilat kryesisht lidhen me shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Ankesa të tilla përfshijnë përdorimin e resurseve publike për fushatë, përdorimin e gjuhës nxitëse dhe urrejtëse, si dhe përfshirjen e fëmijëve në aktivitete politike. Këto shkelje pasqyrojnë një problematikë të dukshme në menaxhimin e fushatës dhe respektimin e parimeve themelore demokratike, duke minuar integritetin e procesit zgjedhor. Për ankesat e

pranuara, PZAP ka nxjerrë gjithsej 149 vendime dhe ka shqiptuar gjopa ndaj subjekteve politike, në total prej 612,100 Euro.

Më së shumti gjopa janë shqiptuar ndaj partisë në pushtet LVV, pasuar nga PDK, LDK dhe AAK-NISMA. Shkelje të ngjashme janë evidentuar edhe për disa parti më të vogla, Koalicioni për Familjen ndërsa janë gjobitur edhe parti të komunitetit serb, ndër to më së shumti Lista Serbe.¹³

Subjektet politike	Vendime	Gjopa
LVV	47	€ 210,500
PDK	28	€ 144,500
LDK	31	€ 136,600
AAK, NISMA	13	€ 37,300
Lista Serbe	6	€ 26,500
Koalicioni për familje	8	€ 18,500
Demokracia Serbe	3	€ 12,000
Partija Kosovovskih Srba (PKS)	2	€ 7,200
Nova Demokratska Stranka (NDS)	2	€ 4,000

¹³ Të dhënat janë marrë nga monitorimi i rregullt i punës së PZAP dhe janë konfirmuar përmes komunikimit me zyrtarët e PZAP-së.

Subjektet politike	Vendime	Gjoha
Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK)	2	€ 3,500
Slobodu Pravdu i Opstanak	1	€ 3,500
PLE	2	€ 3,000
Nasa Bosnjacka Koalicija (NBK)	1	€ 1,500
Koalicioni Vakut	1	€ 1,500
Partia e Ashkalinjëve të Integruar (PAI),	1	€ 1,000
OPRE ROMA Kosova	1	€ 1,000
Gjithsej	149	€ 612,100

Përkundër gjobave të mëdha të shqiptuara nga PZAP gjatë fushatës zgjedhore, vendimet e këtij institucioni kanë pasur një dukuri të dukshme të dënimeve jo uniforme. Ka pasur raste kur për shkelje të ngjashme, si përdorimi i gjuhës nxitëse dhe urrejtëse, PZAP ka shqiptuar dënime të ndryshme për partitë politike. Për shembull, në disa raste për përdorimin e gjuhës nxitëse, dënimet kanë variuar nga 3,000 euro deri në 20,000 euro. Po ashtu, ka pasur një interpretim të ndryshëm të standardeve, siç është rasti i përdorimit të fjalës “mashtues”, që në disa raste nuk është konsideruar shkelje, ndërsa në disa të tjera ka sjellë dënime me gjobë.

Një fenomen tjetër është pasja e dënimeve të ndryshme për shkelje të njëjta, siç është përdorimi i resurseve publike dhe vendosja e materialeve zgjedhore në hapësira publike. Për shembull, në rastin e vendosjes së posterëve në hapësira publike, një subjekt politik u dënua me 4,000 euro, ndërsa një tjetër për shkelje të ngjashme u dënua me 5,500 euro. Këto variacione në dënime reflektojnë një mungesë konsistence dhe uniformiteti në vendimmarrjen e PZAP, duke ngjallur pyetje rreth aplikimit të barabartë të ligjit për të gjitha subjektet politike.

Nga vendimet e shqiptuara nga PZAP, gjithsej 29 vendime janë ankimuar në Gjykatën Supreme. Prej tyre 22 vendime janë vërtetuar nga Gjykata, kurse 7 vendime janë ndryshuar pjesërisht. Pavarësisht anulimit të disa vendimeve nga Gjykata Supreme, është vërejtur se edhe kjo gjykatë nuk ka ndjekur një linjë të qëndrueshme në vendimmarrje për shkelje të ngjashme nga subjektet politike. Kjo ka qenë veçanërisht e dukshme në rastet e dënimeve për përdorim të gjuhës nxitëse dhe urrejtëse, ku shpesh ankesat janë refuzuar si të pabazuara, ndërsa në disa raste janë pranuar dhe janë anuluar vendimet e PZAP-it.

Ky rezultat ka nxjerrë në pah nevojën për përmirësimin e parametrave të vendimmarrjes, duke theksuar rëndësinë e një interpretimi të qartë dhe të barabartë të ligjit, si dhe aplikimin e tij të drejtë për të gjitha subjektet politike.

Rekomandime

Në bazë të gjetjeve nga vëzhgimi i fushatës zgjedhore dhe periudhës që i parapriu fushatës zyrtare, Demokracia në Veprim (DnV) ofron si më poshtë rekomandimet, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e mbarëvajtjes së fushatave zgjedhore në të ardhmen:

Për subjektet politike:

- **Publikimi i hershëm dhe i qasshëm i programeve politike:** Subjektet politike duhet të sigurojnë që programet e tyre të jenë të disponueshme për qytetarët sa më herët dhe në forma të ndryshme publikimi, si në mediat tradicionale dhe platformat online, për të mundësuar një debat të informuar. Programet duhet të shkruhen në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për të gjithë qytetarët dhe të përfshijnë sqarime për burimet financiare dhe realizimin e propozimeve, duke ndihmuar qytetarët të bëjnë zgjedhje të informuara dhe të kuptojnë nëse planet janë të realizueshme brenda mundësive buxhetore të vendit.
- **Pjesëmarrja e qytetarëve dhe përfshirja e grupeve të marginalizuara:** Gjatë fushatës zgjedhore, subjektet politike duhet të sigurohen që të gjithë qytetarët të kenë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në aktivitete, duke siguruar qasje dhe infrastrukturë të nevojshme për personat me aftësi të kufizuara. Për më tepër, në fushata duhet të angazhohen aktivisht gratë dhe të sigurojnë që ato të jenë të përfaqësuara si pjesëmarrëse ashtu edhe si folëse. Gjithashtu, është e rëndësishme të shmangen praktikat që përfshijnë fëmijët në aktivitete politike, pasi kjo është në kundërshtim me ligjin dhe mund të ndikojë negativisht në zhvillimin e fëmijëve.
- **Garantimi i lirisë së grumbullimit gjatë fushatës zgjedhore:** Liria e grumbullimit është një e drejtë themelore që siguron një proces zgjedhor të drejtë. Incidentet e ndodhura gjatë fushatës duhet të shmangen, pasi ato dëmtojnë lirinë e shprehjes dhe ndikojnë negativisht në besimin e qytetarëve. Partitë politike, qytetarët dhe institucionet e sigurisë duhet të sigurojnë një mjedis të sigurt për grumbullime pa dhunë dhe pengesa. Garantimi i kësaj lirie është kyç për një fushatë të drejtë, duke mundësuar qytetarëve të shprehin mendimet e tyre dhe të kontribuojnë në vendimet që do të ndikojnë në të ardhmen e vendit. Po ashtu, është e rëndësishme që të gjitha palët të respektojnë ligjet që mbrojnë këtë liri, për të siguruar një proces të sigurt dhe të drejtë.
- **Fokusimi në programe dhe përmbajtja nga përdorimi i gjuhës nxitëse dhe të urrejtjes:** Subjektet politike duhet të përqendrohen në fjalimet e tyre në propozime konkrete dhe tema që janë thelbësore për rritjen e mirëqenies së qytetarëve. Fjalimet duhet të ofrojnë zgjidhje praktike për çështjet që prekin jetën e përditshme të qytetarëve dhe të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Po ashtu, është e rëndësishme që partitë të abstenojnë nga përdorimi i gjuhës nxitëse dhe të urrejtjes, si dhe nga sulmet personale ose diskriminimi ndaj grupeve të caktuara. Përdorimi i një diskursi të tillë është në kundërshtim me ligjin dhe i dëmshëm për unitetin shoqëror.
- **Garantimi i pjesëmarrjes së pa penguar të mediave dhe mbulimi i drejtë i aktiviteteve të fushatës zgjedhore:** Subjektet politike duhet të sigurojnë mundësi të pa penguar për mediat për të mbuluar aktivitetet e fushatës, duke lejuar një përfaqësim të hapur dhe transparent. Kjo është e rëndësishme për të mundësuar që qytetarët të marrin informacion të plotë dhe të për të gjitha partitë, duke siguruar një proces zgjedhor të drejtë. Media gjithashtu duhet të mbulojnë aktivitetet e të gjitha subjekteve politike në mënyrë të barabartë dhe

objektive, pa favorizuar asnjë palë, për të ruajtur integritetin e procesit zgjedhor. Institucionet që mbikëqyrin median, si Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), duhet të sigurojnë se mediat respektojnë këto parime, duke ndërhyrë në rast të shkeljeve, për të garantuar një proces zgjedhor të drejtë dhe të besueshëm.

Për nivelin qendror dhe lokal:

- **Mos shfrytëzimi i resurseve publike për qëllime elektorale:** Qeveria, në nivel qendror dhe lokal, duhet të abstenojë nga marrja e vendimeve politike ose administrative para dhe gjatë periudhës së fushatës zgjedhore që mund të ndikojnë në orientimin e votës së qytetarëve. Kjo përfshin çdo veprim që mund të krijojë përfitime të perceptuara për një subjekt politik, si dhe vendimmarrje që mund të ndikojnë në favor të një partie. Po ashtu, është thelbësore që të shmanget përdorimi i burimeve publike dhe shërbyesve publikë për qëllime elektorale, përfshirë përdorimin e veturave zyrtare dhe angazhimin e shërbyesve të administratës publike në aktivitete të fushatës, për të siguruar një konkurrencë të barabartë dhe për të ruajtur besimin e qytetarëve në procesin zgjedhor.

Për organet e drejtësisë

- **Garantimi i koherencës dhe objektivitetit të institucioneve gjyqësore:** PZAP dhe Gjykata Supreme duhet të garantojnë koherencë dhe objektivitet në vendimmarrje. Dallimet në vendimet dhe gjobat për shkelje të ngjashme kanë ngritur shqetësime lidhur me trajtimin e paanshëm të shkeljeve dhe kanë ngritur dyshime për favorizimin e disa subjekteve politike. Për të garantuar një zbatim të drejtë dhe të barabartë të ligjit, është e domosdoshme që vendimet e PZAP dhe të Gjykatës Supreme të jenë të qarta, të barabarta dhe koherente për të gjitha subjektet politike. Kjo do të eliminojë çdo perceptim të mundshëm për favorizim dhe do të kontribuojë në një proces zgjedhor më të besueshëm dhe të drejtpërdrejtë, duke siguruar që ligji zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë.



Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action